

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, me seli në P., me objekt kontesti rimbursim mjeteve në vlerë prej 730.00 euro, pas përfundimit të seancës gjyqësore të datës 07.07.2017, në prezencë të autorizuarës së paditëses dhe në mungesë të të paditurës, ndërsa me datë 07.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P., që t’ia paguaj në emër të borxhit kryesor, shumën prej 730.00 euro, me kamatë prej 12% në vit, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve “K. e R.” me seli në P., me datë 26.09.2016, ka parashtruar padinë për kthimin e mejteve të paguara dy here, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në P..

Në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 07.07.2017, në të cilën ka prezantuar e autorizuar e paditëses, e cila drejtpërdrejt në seancë ka deqë dorë nga padia dhe kërkesëpadia e tij, ndaj të paditurit.

Meqenëse, e autorizuar e paditëses ka heqë dorë nga kërkesëpadia në kuptim të nenit 149.2 të LPK-së, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurës, për çka Gjykata në kuptim të nenit 149.1 të LPK-së, pa shqyrtim të mëtejshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij Aktgjykimi, janë dhënë vetëm arsyet që justifikojnë dhënien e tij.

Lidhur me vendimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore të cekur si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi gjykata u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë dhe në bazë të neneve 142, 143, 160 dhe 149 të Ligjit për procedurën kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

III.EK.nr.458/16 me datë 07.07.2017

Gjyqtarja

Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.